**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER XHEVAHIRE H. BRAHAJ**

V2024053390077838451

**DATE 25/03/2024**
**NR REP 1226**

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 25/03/2024, para meje Notere XHEVAHIRE H. BRAHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.1, ISMAIL QEMALI, GENER 2, NR.8, HYRJA NR.2, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT**:
**Shoqëria AD - STAR,** regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS J69102207W,me adresë Lagjja E Re, Përmet., përfaqësuar nga Alfred Çoma, atësia Moisi, amësia Eftali, shtetas Shqiptar, lindur në Këlcyrë, Përmet dhe banues në TIRANË, me adresë Herman Gmainer; Nd. 67; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 18/07/1964, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039182057 dhe nr. personal G40718144J.

**Gëzim Kalbaj,** atësia Mus, amësia Evroni, shtetas Shqiptar, lindur në Bajram Curri, Tropojë dhe banues në TIRANË, me adresë Dora D'istria; Nd. 16; H. 3; Ap. 14; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 26/09/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036945250 dhe nr. personal G80926074W.

**Nuredin Suli,** atësia Nexhip, amësia Anife, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Ndrekë Luca; Nd. 8; H. 1; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 18/04/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036119255 dhe nr. personal G30418180O.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Akt themelimi dhe Statut i Shoqerise MGN-SOLAR ENERGY", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

XHEVAHIRE H. BRAHAJ

Mbeshtetur ne nenin 28 paragrafi 3 te Ligjit Nr 9723/2007 per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument perben:

**AKTI THEMELIMIT DHE STATUTI**
**I**
**" MGN-SOLAR ENERGY SHPK"**

## KAPITULLI I
## THEMELIMI SHOQERISE

### Neni 1.
### Data e Themelimit dhe Emri

1.1 Sot ne daten e nenshkrimit te ketij statute themelohet shoqeria "**MGN**- SOLAR ENERGY" (Shoqeria)

1.2 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe publikimet e leshuara nga Shoqeria pavaresisht nga menyra e dergimit, emri saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:

(i) fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "Sh.p.k"
(ii) numri i ldentifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj
(iii) adresa e regjistruar, dhe pasqyrimin e faktit qe Shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

### Neni 2.
### Forma Ligjore e Shoqerise

2.1 Shoqeria eshte nje entitet ligjor Shqiptar,dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar(shoqeri me pergjegjesi te kufizuar), ne perputhje me Ligjin Nr.9901. date 14.042008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji I Shoqerive"). Emri i shoqerise ndiqet ne menyre te pandashme nga shkurtimi i cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

### Neni 3.
### Selia Shoqerise

3.1.Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, selia e Shoqerise ndodhet ne adresen Rr. "Perlat Rexhepi", Pallati UNIKON, Kati II, Tiranë, Shqipëri. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

### Neni 4.
### Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar.

## KAPITULLI II
## OBJEKTI

### Neni 5.
### Objekti i Shoqerise

5.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte te kryeje cfare eshte e nevojshme dhe e pershtatshme per te realizuar te drejtat e detyrimet qe rrjedhin per Zhvillimin e Projektit te saj per park fotovoltaik perfshire, por pa u kufizuar ne: projektimin, ndertimin, instalimin, komisionimin, finacimin, operimin, permiresimin, dhe mirembajtjen e parkut te prodhimit te energjise nga dielli dhe infrastruktures sherbyese, perfshire panelet fotovoltaike te ndodhura ne Libofshe, Fier, Shqiperi ("Parku Fotovoltaik") si dhe nenstacionin e parkut, linjen e transmetimit te energjise elektrike qe do lidhe Parkun Fotovoltaik me rrjetin shqiptar te energjise; te prodhoje e shese energji elektrike te prodhuar nga Parku Fotovoltaik; te zoteroje te drejta kalimi qe do ta lejojne te lidhe Parkun Fotovoltaik me rrjetin shqipetar te energjise elektrike me ane te linjes se transmetimit.

5.2 Pervec sa me siper, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm. Per arritjen e qellimit te mesiperm, Shoqeria mund te kryeje cdo transaksion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajteshme, dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qeraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i vlefshem ose i nevojshem ne menyre qe te ushtrohet objekti i Shoqerise

### Neni 6.
### Ndryshime

6.1 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne perputhje me dspozitat e ketij statuti.

## KAPITULLI III
## KAPITALI THEMELTAR; KUOTAT

### Neni 7.
### Kapitali

7.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ne EUR 1,000, ose ekuivalenti 111,400 Leke.

### Neni 8.
### Ortaket dhe Kuotat

8.1 Ortaket themelues te shoqerise jane:

**8.1.1 Ortaket**

- **Shoqeria "AD STAR sh.p.k**, e regjistruar si person juridik me nr. NIPT J69102207W me perfaqesues ligjor z.Alfred Coma , atësia Moisi, amësia Eftali, shtetas Shqiptar, lindur në Këlcyrë, Përmet dhe banues në TIRANË, me adresë Herman Gmainer; Nd. 67; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 18/07/1964, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037007988 dhe nr. personal G40718144J.

- **Gëzim Kalbaj,** atësia Mus, amësia Evroni, shtetas Shqiptar, lindur në Bajram Curri, Tropojë dhe banues në TIRANË, me adresë Dora D'istria; Nd. 16; H. 3; Ap. 14; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 26/09/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036945250 dhe nr. personal G80926074W.

- **Nuredin Suli,** atësia Nexhip, amësia Anife, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Ndrekë Luca; Nd. 8; H. 1; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 18/04/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036119255 dhe nr. personal G30418180O.

**8.1.2. Kuotat**

**Shoqeria "AD STAR sh.p.k**, e regjistruar si person juridik me nr. NIPT J69102207W i cili zoteron 1 (nje) pjese, me vlere nominale 500 euro ose ekuivalenti 55,700 Leke e shprehur ne perqindje 50 % te kapitalit,

**Gëzim Kalbaj**, i cili zoteron 1 (nje)pjese, me vlere nominale 250 euro ose ekuivalenti 27,850 Leke e shprehur ne perqindje 25 % te kapitalit.

**Nuredin Suli,** i cili zoteron 1 (nje)pjese, me vlere nominale 250 euro ose ekuivalenti 27,850 Leke e shprehur ne perqindje 25 % te kapitalit.

**Neni 9.**
**Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar**

9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive

9.2 Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para ose me ane te kontributeve ne natyre, si dhe me perfshirjen e rezervave (nese ka) ose fitimit apo kthimit te borxhit ne kapital.

9.3 Zmadhimi i kapitalit mund te behet duke emetuar kuota te reja apo duke rritur vleren nominale te kuotave ekzistuese

**Neni 10.**
**Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

10.1 Ortaket do te kene akses te plote ne cdo informacion dhe te dhene qe ka lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, perfshire te drejten per te kontrolluar regjistrat e Shoqerise dhe cdo dokument tjeter.

10.2 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri i ketyre Kuotave.

**Neni 11.**
**Transferimi Kuotave**

11.1 Kuotat ne Shoqeri jane lirisht te transferueshme.

## KAPITULLI IV
## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

### Neni 12.
### Kompetencat

12.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi kontrollues dhe vendimmarres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

12.2. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me ceshtjet e meposhtme, por pa u kufizuar vetem ne to:

(i) shperndarjen e dividentit nga fitimet apo rezervat;

(ii) pezullimin e aktiviteteve te Shoqerise dhe/ose perfundimin, shperberjen apo likujdimin e

Shoqerise;

(iii) ndryshimet, apo zevendesimet ne statutin e Shoqerise;

(iv) ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;

(v) bashkimin, perqendrimin apo perzirjen me shoqeri te tjera, apo ndarjen e Shoqerise;

(vi) zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;

(vii) emerimi dhe shkarkimi eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuidatoreve;

(viii) miratimin e pasqyrave finance

are vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise, apo te ndryshimeve te tyre;

(ix) emerimin, pezullimin apo shkarkimin ne cdo kohe te Administratoreve;

(x) aprovimin e strategjise se bisnesit se Shoqerise, planit te biznesit, planeve finaciare dhe buxhetit;

(xi) shitjen e ndonje shoqerije bije/filiali ose hyrjen ne shoqeri te perbashketa (joint venture) partneritete apo marreveshje te ngjashme;

(xii) shitjen apo disponimin (perfshire qiradhenien paleve te treta) nga Shoqeria te aseteve qe perfaqesojne nje pjese materiale/substanciale te aseteve te Shoqerise;

(xiii) te miratoje cdo hua qe konsiderohet me vlere, ose paradhenie qe i jepet cdo personi te bredshem apo te jashtem, firme, shoqerie, opo cdo bisnesi tjeter;

(xiv) ceshtje te tjera te cilat do te parashikohen nga Ortaket.

### Neni 13.
### Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.

13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda tre (3) muajve ne vazhdim.

13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithe aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

13.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje asete qe i perkasin nje ortaku te Shoqerise, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

13.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asambleja e Pergjithshme do te vendose ne baze te nje raporti nga nje ekspert kontabel i autorizuar, qe dorezohet tek kjo Asamble, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratoret cdo tre muaj me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratoret gjate atij tre mujori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise dhemarrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e Ortakeve, perishire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord ne menyre unanime.

13.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

**Neni 14.**
**Menyra e Thirrjes**

14.1. Asambleja e Pergjithshme vendos per ceshtjet e paraqitura ne nenet e mesiperme 12&13. nepermjet thirrjes se mbledhjeve.

14.2. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve

14.3. Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te Tiranes, Shqiperi, ne cdo qytet te botes sic bihet dakord midis Ortakeve apo komunikimi online që realizohet nëpërmjet mediave sociale dhe platformave të ndryshme që ekzistojnë në internet.

14.4. Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

14.5. Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

**Neni 15.**
**Ruajtja e procesverbaleve**

15.1 Administratoret duhet te ruajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

## KAPITULLI V
## ADMINISTRATORET

**Neni 16.**
**Administratoret**

16.1. Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administratori/et mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.

16.2 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti. Shoqeria drejtohet nga:

a) Dario Arapi, atësia Petrit, amësia Adriana, shtetas Shqiptare, lindur në Berat, me adresë Lagjia Çlirim, rruga Kongresi manastirit, Pall.Nr.8, H.8, Berat, lindur më 14/10/2000, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033769655 dhe nr. personal K01014074C.

16.3 Kohezgjatja e emerimit te Administratoreve eshte per nje periudhe 1 vjecare, me te drejte riperteritje te ketij mandati.

16.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori/et njohin ne se marredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; ne ketedrejtim vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Administratoret me shumice te thjeshte votash.

**Neni 17.**
**Kompetencat dhe Detyrimet**

17.1. Administratoret kane te drejte qe se bashku apo vec e vec te bejne:

(i) Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 13;

(ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergj ithshme;

(iii) Perfaqesimin e Shoqerise dhe lidhjen e kontratave;

(iv) Te sigurohen per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;

(v) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe I paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme;

(vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, kur eshte e nevoj shme;

(vii) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e transaksioneve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise ose ndryshimin e kushteve te kontratave materiale per Shoqerine;

(viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

17.2 Administratori/et mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori/et duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaku/et.

**Neni 18.**
**Detyrimi i Besnikerise dhe Pergjegjesia**

18.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise,sipas neneve 14,15,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, Administratoret detyrohen:

(i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, qe perfshin vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;

(ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

(iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;

(iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave te tyre personale me ato te Shoqerise;

(v) te garantoje miratimin e dhene per marreveshjet e pershkruara ne dispozitat e pikes 3 te nenit 13 te Ligjit te shoqerive;

(vi) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

18.2. Administratoret mbajne pergjegjesi per cdo veprim apo mungese veprimi, me perjashtim te rasteve kur veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacionit te lidhur ne menyre te drejteperdrejte me qellimet e Shoqerise.

18.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes. Gjithashtu, Administratori duhet ti kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator, ata jane pergjegjes ndaj Shoqerise ne menyre solidare dhe vecmas.

## KAPITULLI VI
## ADMINISTRIMI FINANCIAR

### Neni 19.
### Eksperti Kontabel i Autorizuar

19.1. Ortaket duhet te caktojne auditorin e Shoqerise.

19.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## KAPITULLI VII
## AKTIVITETI

### Neni 20.
### Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne diten e pare muaji Janar dhe perfundon ne diten e 31-te te muajit Dhjetor te secilit vit.

### Neni 21.
### Mbajtja e Llogarive

21.1. Shoqeria do te mbaje Ilogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

### Neni 22.
### Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

22.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me kete Statut, dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

(I) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit; dhe

(ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te a rdhshem.

22.3 Administratoret leshojne nje"certifikate te aftesise paguese", e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar permbush kerkesat e pikes 22.2 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta Ieshojne kete certifikate.

22.4 Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## KAPITULLI VIII
## NDRYSHIMI FORMES LIGJORE; PRISHJA

### Neni 23.
### Ndryshimi i Formes Liqjore

23.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 12 te Statutit dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

23.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

**Neni 24.**
**Prishja e Shoqerise**

24.1. Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

(i) me vendim te Asamblese se Pergj ithshme; me hapjen e procedurave te likujdimit/falimenti mit;

(iii) me vendim te Gjykates;

(iv) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

24.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr. 9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia dergon vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

**KAPITULLI IX**
**TE NDRYSHME**
**Neni 25.**
**Te tiera**

25.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

Per

**MGN SOLAR ENERGY SHPK**

O R T A K E T

Shoqeria AD STAR SHPK

Perfaqesuar nga

Alfred Çoma

Alfred Çoma
_______________________

NDËRTIM "AD-STAR" Sh.p.k. ARKEOLOGJI & RESTAURIME

Gezim Kalbaj

GEZIM KALBAJ
_______________________

Nuredin Suli

Nuredin Suli
_______________________